

**VENDIM**  
**Nr.439, datë 2.12.1991**

**PËR TAKSAT DOGANORE TË MALLRAVE TË IMPORTIT**

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli Ministrave

**VENDOSI:**

1. Personat fizikë a juridikë që zhvillojnë veprimtari ekonomike e tregtare për importin e mallrave në territorin e Republikës së Shqipërisë, i nënhtrohen pagimit të taksave doganore sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, me përjashtim të rasteve kur:

a) Ka marrëveshje ë miratuara na qeveria për përjashtimin e ndërsjellë të iporteve nga taksat doganore.

b) Importohen mallra në formën e ndihmave humanitare falas nga shtetet e ndryshme ose organizatat, shoqatat e institucionet, bamirëse.

c) Mallrat e importuara janë të dëmtuara ose të prishura e të papërdorshme si prodhim ose si material.

ç) Kryhet importimi i përkohshëm i mallrave, kur ato nuk shiten brenda vendit ose nuk u nënshtrohen përpunimit e proceseve të tjera, por në të gjitha rastet pasi vertetohet nga organet doganore regjimi i lejimit të përkohshëm .

3. Kur mallrat e importuara destinohen për lëndë të para ose materiale, të cilat u nënshtrohen proceseve përpunuese dhe materializohen në produkte të gatshme që eksportohen, taksat doganore të arkëtuara për importin e tyre u rimbursohen importuesve, kur organet doganore vërtetojnë në sasi e vleftë eksportimin e tyre, mbi bazën e të gjitha dokumentave që kërkohen prej saj. Rimbursimi bëhet në masën 99 për qind të masës së taksës doganore të importit të paguar.

4. Taksat doganore të mallrave të importit, të përcaktuara në listën që i bashkëngjitet këtij vendimi, llogariten në përqindje mbi çmimin e blerjes në valutë të konvertuar me kursin ekonomik në fuqi, kurse për automjetet e përdorura me taksë fikse në lekë.

5. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.52 datë 1.2.1991 "Për doganat", pika 9 ndryshohet si vijon:

"Autoveturat e motoçikletat që sillen ose dërgohen nga jashtë shtetit për nevoja familjare e vetjake, zbatohen këto taksa doganore:

- Për autoveturat, mikrobusët, kamionçinat dhe motoçikletat, kur janë të reja 20 për qind të çmimit të blerjes në valutë, të konvertuar me kursin ekonomik në fuqi.

- Për autoveturat që kanë përshkruar mbi 10 mijë km, zbatohet taksë doganore në masën 15 mijë lekë.

- Për mikrobusët dhe kamionçinat që kanë përshkruar mbi 10 mijë km, zbatohet taksë doganore në masën 30 mijë lekë.

- Për motoçikletat e triçiklet të të gjitha llojeve që kanë përshkruar mbi 5 mijë km, zbatohet taksë doganore në masën 2000 lekë.

6. Pika 8 e vendimit të Këshillit të ministrave nr.52 datë 01.02.1991 "Për doganat" si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohen.

7. Ministri i Financave të nxjerrë udhëzimin përkatës në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**Ylli Bufi**

**TABELA TAKSAVE DOGANORE PËR MALLRAT E IMPORTIT**

1. Lëndët e para dhe materialet për prodhimin e mallrave të konsumit në degët e industrisë së lehtë e ushqimore\_\_\_\_\_ 5
2. Mallrat e konsumit ushqimor bazë\_\_\_\_\_ 5
3. Mallrat ushqimore të përpunuara\_\_\_\_\_ 10
4. Mallrat e konsumit industrial të përpunuara (tekstile, konfeksione etj).\_\_\_\_ 10
5. Mallrat elektroshtëpiake, radio, televizorë, video, frigoriferë, radiomagntofona, makina larëse etj.\_\_\_\_\_10
6. Mallrat industriale të përpunuara (bizhuteri, ora, prodhime artistike etj).\_\_\_\_ 30
7. Lëndët e para dhe materialet për prodhimin e mjeteve të proimit\_\_\_\_\_ 5
8. Makineritë dhe pajisjet \_\_\_\_\_ 5
9. Librat, revistat, gazetatat dhe lëndët e para për shtypshkrime e artikuj shkollorë të domosdoshëm\_\_\_\_\_ 5
10. Duhanet, cigaret, pijet alkoolike e joalkoolike dhe kafeja\_\_\_\_\_10
11. Mallrat e përfshira në grupet e mësipërme\_\_\_\_\_20
12. Automjetet e reja të të gjitha llojeve\_\_\_\_\_20
13. Automjetet e përdorura:
  - a) Motoçikletat e triçiklet të të gjitha llojeve që kanë përshkruar mbi 5 mijë km\_\_\_\_\_2 mijë lekë
  - b) Për autoveturat që kanë përshkruar mbi 10 mijë km\_\_\_\_\_15 mijë lekë
  - c) Për mikrobusët, kamionçinat, furgonat dhe kamionët deri në tre ton mbi 10 mijë km të përdorur\_\_\_\_\_30 mijë lekë
  - ç) Kamionët mbi 3 tonë dhe autobusët mbi 10 mijë km, të përdorur\_\_\_\_\_50 mijë lekë.